




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra /Kabinet of the Ministër*



Nr. 280  
Data: 27.02.2024

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L – 117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 101 të Ligjit Nr. 03/L – 233 për Mbrojtjen e Natyrës, nenin 48 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2. pika 2.2.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 26/2012 për Qarkullim Ndërkufitar dhe Tregtinë me Llojet e Egra të Mbrojtura, Aktgjykimit P.Nr. 273/20 datë 30.12.2020 nga Gjykata Themelore në Gjilan, Memorandumit të Bashkëpunimi për transferimin e kafshës së llojit Panthera Leo (Luan) i datës 18 qershor 2021 i lidhur në mes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Kosovës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë, nxjerr:

#### V E N D I M

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës autorizon Fondacionin për Mbrojtjen e Kafshëve “VIER PFOTEN Kosova” për përkujdesje të llojit shtazor Luani “Gjoni” i gjinisë mashkull, me numër mikroçipi 00809000001452, transferin e tij në Republikën e Shqipërisë.
2. Me këtë autorizim Fondacionit për Mbrojtjen e Kafshëve “VIER PFOTEN Kosova” i jepet e drejta që në koordinim me Fondacionin FOUR PAWS International të bënë të mundur transferin e përhershëm të luanit në njërën nga qendrat e saj për rehabilitimin e maceve të mëdha.
3. Ky autorizim jepet në zbatim të:
  - 3.1. nenit 101 të Ligjit Nr. 03/L – 233 për Mbrojtjen e Natyrës që parasheh procedurat rreth qarkullimit ndërkufitar të llojeve të egra të mbrojtura,

3.2. nenit 48 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2. pika 2.2.1. të Udhëzimit Administrativ Nr. 26/2012 për Qarkullim Ndërkufitar dhe Tregtinë me Llojet e Egra të Mbrojtura, që parasheh procedurat rreth transportimit të kafshëve të konfiskuara,

3.3. pikës IV të Aktgjykimit P.Nr. 273/20 datë 30.12.2020 nga Gjykata Themelore në Gjilan e cila obligon që malli i sekuestruar përkohësisht Luanit Gjoni (*Panthera Leo*) i jepet nën menaxhim Agjencisë për Menaxhimin e Mallit të Sekuestruar, Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Komisionit ndër Ministror të MMPHI - së, si dhe

3.4. dispozitave ligjore të parapara në Memorandumin e Bashkëpunimit për transferimin e kafshës së llojit *Panthera Leo* (Luan) i lidhur në mes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Kosovës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë ku synohet përgatitja nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë e dokumentacionit të nevojshëm sipas Konventës së CITES, me qëllim të lehtësimit të procedurave administrative për transferimin e kafshës së llojit *Panthera Leo* (Luan) të konfiskuar nga autoritetet gjyqësore të Republikës së Kosovës, në një qendër strehimi për macet e mëdha të organizatës FOUR PAWS, në mënyrë të tillë që të minimizohet rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose keqtrajtimit të tij.

4. Kjo kafshë nuk ka vlerë tregtare (komerciale) dhe nuk mund të shfrytëzohet për asnjë qëllim komercial.

5. Obligohet Fondacioni për Mbrojtjen e Kafshëve "VIER PFOTEN Kosova" të bëjë transferin dhe pajisjen me dokumentacionin e nevojshme siç përcaktohet me dispozita ligjore të parapara në Ligjin Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës, Udhëzimin Administrativ Nr. 26/2012 për Qarkullim Ndërkufitar dhe Tregtinë me Llojet e Egra të Mbrojtura, Memorandumit të Bashkëpunimi për transferimin e kafshës së llojit *Panthera Leo* (Luan) i dt. 18.06.2021 si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore përkatëse në fuqi.

6. Fondacioni për Mbrojtjen e Kafshëve "VIER PFOTEN Kosova" do të njoftoj të gjitha institucionet përfshira dhe ato përgjegjëse nga fillimi deri në përfundimin e transferimit të kafshës së llojit *Panthera Leo* (Luan).

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Liburan Aliu  
Ministër i Ministrisë së Mjedisit,  
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës



**Vendimi t'i dërgohet:**

- Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve "VIER PFOTEN Kosova";
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor të MMPHI;

- Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave;
- Divizionit për Komunikimin me Publikun të MMPHI;
- Arkivit të MMPHI-së.